

MONITORIMI I RASTEVE GJYQËSORE KU GAZETARË JANË TË AKUZUAR PËR SHPIFJE DHE OFENDIM

Shkup, Shtator 2011

MONITORIMI I RASTEVE GJYQËSORE KU GAZETARË JANË TË AKUZUAR PËR SHPIFJE DHE OFENDIM

Botues: Koalicioni shoqatave qytetare “Të gjithë për gjykim të drejtë”
Rr. Maqedonia 11/2-10, 1000 Shkup
Tel: +389 2 321263 Faks: +389 23215264
E-mail: contact@all4fairtrials.org.mk
Web: www.all4fairtrials.org.mk

Për botuesin: Petre Mrkev, president

Autor: m-r Dragana Kiprijanovska

Redaktor: m-r Aleksandar Blazeski, koordinator e projektit

Implementues i projektit: Koalicioni „Të gjithë për gjykime të drejta“

Bashkëpunëtor: Daniel Mitkovski

Dizajni dhe botimi: Grafohartija

Tirazhi: 100

PËRMBAJTJA:

PËRMBAJTJA:	1
HYRJE	3
LËNDA DHE QËLLIMI I HULUMTIMIT	5
QASJA METODOLOGJIKE	6
KAPITULLI I	11
MBROJTJA JURIDIKE E LIRISË SË SHPREHJES – DILEMA DHE SFIDA BASHKËKOHORE	11
1. Liria e shprehjes si e drejtë themelore e njeriut.....	11
2. Aktet ndërkombëtare dhe standardet për mbrojtjen e lirisë së shprehjes	12
3. Bazat e lejuara për kufizimin e lirisë së shprehjes	14
4. Korniza ligjore nacionale.....	15
KAPITULLI II	19
SHPIFJA DHE OFENDIMI NË LEGJISLACIONIN POZITIV PENAL	19
1. Nderi dhe reputacioni si objekt i mbrojtur në të drejtën penale	19
1.1 Për nevojën e mbrojtjes (penale) juridike të reputacionit	19
2. Rreullat e posaçme dhe kushtet për përgjegjësi për veprat shpifje dhe ofendim në legjislacionin kombëtar penal	20
3. Shpifja dhe ofendimi në sistematikën e pjesës së veçantë të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë.....	21
3.1 Shpifja.....	21
3.2 Ofendimi	23
3.3 Sistemi i sanksioneve penale	24
KAPITULLI III	27
ANALIZA E REZULTATEVE TË MONITORIMIT TË RASTEVE GJYQËSORE NË TË CILAT GAZETARË JANË TË AKUZUAR PËR SHPIFJE DHE OFENDIM	27
1. Disa informata të përgjithshme rreth lëndëve të monitoruara	27
1.1 Periudha kohore në të cilën zbatohet monitorimi	27
1.2 Juridiksioni i gjykatave për veprat penale të kryera nëpërmjet shtypit, raste të regjistruara sipas rajoneve	27
1.3 Pjesëmarrja procentuale e veprave penale shpifje dhe ofendim	29
1.4 Disa specifika në lidhje me subjektet e veprave penale shpifje dhe ofendim në periudhën e analizuar.....	30
2. Fillimi dhe kohëzgjatja e procedurës penale	32
2.1 Çfarë intervali kohor ka kaluar nga koha e kryerjes së veprës penale deri në parashtrimin e padisë private?.....	32
2.2 Cilii është profili i paditësit privat?	33

2.3 Periudha kohore prej parashtrimit të padisë private deri në caktimin e seancën së parë	34
2.4 Faktorët tjerë që ndikojnë në kohëzgjatjen e procedurës	35
2.5 Ndërprerja e seancës kryesore	37
2.6 Në vend të konkluzionit	38
3. Sanksionimi i gazetarëve dhe redaktorëve kryesore të akuzuar për shpifje dhe ofendim	38
KONKLUZIONE	39
4. (Mos) respektimi i standardeve për gjykim të drejtë	40
4.1 Gjykimi në afat të arsyeshëm	40
4.2 Cila është situata aktuale në jurisprudencën e brendshme në lidhje me respektimin e standardeve për gjykim në afat të arsyeshëm?	41
4.3 E drejta për pjesëmarrje efektive në procedurë penale	43
4.4 Procedura dëshmuese	44
4.5 Gjykimi në mungesë	45
4.6 Tërheqja (anulimi) e padisë private	46
REKOMANDIME	49
5. Aktgjykimi, lloji i aktgjykimit dhe politikës e dënimit	49
KONKLUZIONE	51
REKOMANDIME	54
LITERATURA	56
DOKUMENTE NDËRKOMBËTARE:	57
PRAKTIKA E GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT LIDHUR ME LIRINË E MENDIMIT DHE SHPREHJES	58
WWW. AKADEMIKA.COM.MK (BAZA E LEGJISLACIONIT POZITIV TË RM)	59

HYRJE

Projekti "**Monitorimi i rasteve gjyqësore në të cilat gazetarë janë të akuzuar për shpifje dhe ofendim**" zbatohet për herë të dytë në gjykatat e Republikës së Maqedonisë, nga Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë." Zbatimi i saj është bazuar në vëzhgimin e një numri të caktuar të lëndëve penale në të cilat gazetarë dhe redaktorë përgjegjës dhe kryesorë janë të akuzuar për shpifje dhe ofendim, në mënyrë që të nxirren konkluzione të përshtatshme në lidhje me veprat penale të përmendura në praktikën kombëtare gjyqësore, efikasitetin e veprimit nga ana e autoriteteve dhe veçanërisht, respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, të garantuara nga Kushtetuta dhe ligjet, para gjykatave në procedurë penale.

Natyrisht, analiza e të dhënave të marra nga studimi nuk mund të paramendohen pa marrë në konsideratë çështjet e lidhura me kornizën bazë mbrojtëse të lirisë së shprehjes, ose më saktë, referencat mbi standardet e vendosura ndërkombëtare dhe legjislacionit kombëtar penal tek e cila qëndron nevoja e gjetjes së një bilanci të përshtatshëm ndërmjet së drejtës së lirisë së shprehjes, si një nga të drejtat themelore të përcaktuara në instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare dhe së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare, reputacionit dhe dinjitetit të individëve që shpesh mund të jetë në kolizion.

Për atë qëllim, para se ti qasemi dhe analizojmë hollësisht të dhënat e fituara mbi veprat penale ofendim dhe shpifje dhe pjesëmarrjen e tyre në praktikën gjyqësore para gjykatave në Republikën e Maqedonisë në periudhën raportuese tetor, 2010 - korrik 2011, do të pasojë një pasqyrë e shkurtër teorike në lidhje me veprat shpifje dhe ofendim, vendosjen e tyre në sistematikën e pjesës së posacme të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë, për rëndësinë e reputacionit si një objekt i mbrojtur në të drejtën penale dhe nevojën për të aktivizuar mekanizmin penal mbrojtës në këtë fushë.

Veçanërisht duhet të respektohet fakti se liria e mediave, në imazhin e ndryshuar të vlerave të sistemit, hap një seri sfidash dhe dilemash të cilat meritojnë vëmendje të veçantë. Këtu, sidoqoftë, mbetet konceptim kryesor sipas të cilit gëzimi i një të drejte nga individ, në asnjë rast, nuk duhet të çenojë ose kufizojë të drejtën e një personi tjetër. E kundërta do të thotë vlerësim të ndryshëm, gjegjësisht ofrim i nivelit të ndryshëm të mbrojtjes, të të drejtave të barabarta për çdo individ.

Kushtet dhe rregullat e posaçme për përgjegjësi për vepra penale shpifje dhe ofendim në legjislacionin kombëtar penal gjithashtu paraqesin një pjesë integrale të prezantimeve tona dhe vëmendje të veçantë meritojnë proceset e reformës në sistemin e sanksioneve të cilat shkojnë drejt dënimit më të butë të kryerësve të këtyre penale. Para se ti kthehemi analizës së detajuar të të dhënave nga anketa, shkurtimisht do të shfaqen edhe vendimet ligjore që ofrojnë mundësi për të imponuar vërejtje gjyqësore, për më shumë, edhe lirimin

nga dënimi i autorit të veprës, kur është fjala për aktet e ofendimit dhe shpifjes konform legjislacionit penal kombëtar.

Së fundi, në pjesën e tretë të analizës, detalisht janë të respektuara çështjet kyçe të lidhura me veprat penale shpifje dhe ofendim përmes prizmës së praktikës gjyqësore vendase.

Gjatë analizës dhe përvojës praktike të lidhura me temën tonë, janë marrë në konsideratë disa pika kryesore të referimit, duke përfshirë:

- periudha kohore në të cilën kryhet vëzhgimi;
- Pjesëmarrja e veprave penale shpifje dhe ofendim në rastet kur gazetarët paraqiten si kryerës të veprave penale të sipërpërmendura;
- përgjegjësia penale e personave juridik për veprat shpifje dhe ofendim;
- Fillimi dhe kohëzgjatja e procedurës penale për vepra të tilla kur është fjala për paraprakisht rreth të përcaktuar të shkelësve (gazetarë dhe redaktorë kryesorë dhe përgjegjës)¹;
- intervali kohor nga koha e kryerjes së veprës penale deri tek parashtrimi i padisë private për vepra shpifje dhe / ose ofendim;
- Periudha kohore prej paraqitjes së padisë private deri në caktimin e seancës së parë;
- shkaqet që ndikojnë në anulimin e procedurës penale në rastin e kryerjes së veprave penale shpifje dhe ofendim në të cilat në cilësinë e të akuzuarve paraqiten gazetarët dhe redaktorët kryesorë;
- sanksionimin e gazetarëve dhe redaktorëve përgjegjës të akuzuar për shpifje dhe ofendim;
- (mos) respektimi i standardeve për gjykim të drejtë, kur është fjala për këto vepra penale nga gjykatat e brendshme para së cilave procesuohen veprat penale për shpifje dhe ofendim, duke marrë parasysh standardet bazë të përcaktuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Praktika e mekanizmeve tjera (jashta gjyqësore) Mekanizmat për "përfundim" të lëndëve të cilat kanë të bëjnë me veprat penale shpifje dhe ofendim.

¹ Është e nevojshme të theksohet se objekt i analizave paraqesin rastet ku bëhet fjalë për shpifje dhe ofendim, ku në cilësinë e të akuzuarit paraqiten jo vetëm gazetarët por edhe redaktorët kryesorë dhe përgjegjës, kështu, të dhënat që më vonë do të paraqiten u referohen secilës nga kategoritë e personave të sipërpërmendur.

LËNDA DHE QËLLIMI I HULUMTIMIT

Në tetor 2010, Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë" filloi me realizimin e projektit **"Monitorimi i rasteve gjyqësore në të cilat gazetarë janë të akuzuar për shpifje dhe ofendim"**. Projektii është mbështetur financiarisht nga Fondacioni Instituti Shoqëria e Hapur - Maqedoni dhe Rrjeti Programi për mediat - Londër, ndërsa u realizua në bashkëpunim me OJQ-të partnere - anëtare të Koalicionit, mediat, Instituti Maqedonas për Media, Shoqata e Gazetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe gjykatat themelore, duke mbuluar të gjithë territorin e Maqedonisë.

Duke marrë parasysh aspiratën e sigurimit të informacioneve të paanshme dhe të besueshme për gjendjen aktuale në nivel kombëtar në drejtim të ndjekjes dhe sanksionimit të gazetarëve të akuzuar për vepra shpifje dhe ofendim në këtë projekt janë ndërmarrë disa aktivitete, si:

- Identifikimi i procedurave penale në të cilat gazetarë dhe / ose redaktorë kryesorë janë të akuzuar për shpifje dhe ofendim;
 - Vëzhgimi i një numri të lëndëve (77) në gjykatat themelore që të mund të nxirren konkluzione përkatëse në lidhje me lëvizjen e veprave penale të përmendura në praktikën kombëtare gjyqësore, efikasitetin në veprimin nga ana e autoriteteve dhe veçanërisht, respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut;
 - Përcaktimi i kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore dhe regjistrimi i faktorëve që ndikojnë në vonimin (e panevojshëm) të procedurës duke respektuar standardet e përcaktuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe legjislacionin kombëtar;
 - Të kuptuarit e përvojave të praktikës gjyqësore në lidhje me përgjegjësinë e mediave si persona juridikë për veprat shpifje dhe ofendim;
 - Analiza e politikës ndëshkuese të gjykatave;
 - Përpunimi statistikor dhe analiza e të dhënave të përmbajtura në pyetësorët për mbikëqyrje;

Një nga objektivat kryesore të projektit ndër të tjera është që të arrijhet deri te të të kuptuarit më të gjërë të situatës aktuale në gjyqësi dhe në këtë drejtim, për të marrë masat e duhura për të kapërcyer dobësitë e regjistruara. Së fundi, formulimi i konkluzioneve dhe rekomandimeve konkrete bazuar në të dhënat e marra është i një rëndësie të madhe dhe duhet të ndihmojë në krijimin e vendimeve racionale dhe të balancuara në njërën anë, të sigurojë mbrojtjen dhe respektimin e lirisë së gazetarëve, por në të njëjtën kohë të minimizojë rrezikun e dëmtimit të reputacionit të të tjerëve.

QASJA METODOLOGJIKE

Të dhënat të cilat janë objekt i analizës janë mbledhur përmes monitorimit të proceseve penale në të cilat gazetarët janë akuzuar për shpifje dhe ofendim. Monitorimi u krye nga 6 monitorues të shpërndarë në ekipe nga dy të cilët mbuluan territorin e Gjykatës Themelore në Shkup, Kumanovë, Tetovë dhe Manastir. Ndërsa, vëzhguesit e zgjedhur kaluan trajnimin shtesë me qëllim që të aftësohen për ti monitoruar rastet gjyqësore të këtij lloji, ku edhe ishin shumë të njohtuar me mundësinë për ti rregjistruar vërejtjet e tyre për mbarrëvajtjen e procesit.

Hulumtimi u krye në bazë të instrumentit të përgatitur më parë - pyetësorit për vëzhgim, i përgatitur posaçërisht dhe i përshtatur për qëllime të kësaj analize. Kështu të dhënat e mbledhura ishin të vedosura dhe të sistematizuara në një bazë të veçantë të të dhënave, nëpërmjet së cilës bëhet analiza cilësore dhe sasiore e të dhënave. Përmbajtja e pyetësorit përfshin të gjitha fazat e procedurës penale dhe me konceptimin e tij lejon që të marret informacion mbi segmente të veçanta të objektit të kërkimit, si:

- Në cilën gjykatë është lëndë, emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit që kryeson me lëndën;
- Data e monitorimit, kohëzgjatja e seancës, si dhe cila seancë është në rradhë për lëndën konkrete;
- Vepra penale për të cilën udhëhiqet procedura (shpifje dhe / apo ofendim)
- Emri, mbiemri dhe profesioni i paditësit privat;
- Të dhënat e të akuzuarit (pandehurit);
- Vepra penale dhe përshkrimi i rastit konkret për të cilin udhëhiqet procedura;
- A është ofruar pajtim dhe në çfarë forme (falje, falje publike) dhe a është pranuar falja;
- Intervali kohor nga koha e kryerjes së veprës deri në parashtrimin e padisë private, nga cila palë është dorëzuar, dhe periudhën nga dorëzimi i ankesës deri në caktimin e séances së parë;
- A është dorëzuar propozim për realizimin e kërkesës pronësoro – juridike nga ana e paditësit dhe në çfarë lartësie;
- A është bërë dorëzimi i rregullt i thirrjeve personave prania e të cilëve është e nevojshme në seancën kryesore dhe se si ato janë njoftuar;
- Të dhëna se në sa raste është gjykuar në mungesë ose lëshuar urdhër për kapje;
- Arsyet për shtyrjen dhe ndërprerjen e gjykimit;
- Data dhe koha për kurë është shtyer gjykimi;;
- Rrjedha e procedurës dëshmuese para gjykatës;
- A janë respektuar standardet për gjykim të drejtë dhe fer;
- Detajet e aktgjykimit (kur është shpallur aktgjykimi, llojin e aktgjykimi dhe të sanksionit penal, është konstatuar mos ndëshkim I të akuzuarit për shkak se ka dëshmuar se ka bazë të arsyeshme për të besuar në atë që unë ka thënë);
- Periudha kohore prej fillimit të procesit gjyqësor deri në publikimin e aktgjykimit.

Me qëllim të zbatimit efektiv të monitorimit të rasteve gjyqësore², së pari, ishte e nevojshme të identifikohen rastet penale ku të akuzuar për vepra shpifje dhe ofendim paraqiten gazetarë, përfshirë edhe redaktorë kryesorë dhe përgjegjës. Në këtë kuptim, u imponuan disa vështirësi duke patur parasysh faktin se në praktikë nuk ka raporte të veçanta statistikore vjetore ku janë të regjistruara proceset gjyqësore kundër gazetarëve. Në këtë drejtim, u dërguan letra deri tek të gjitha gjykatat themelore në Republikën e Maqedonisë dhe u realizuan takime me personat përgjegjës për marrëdhëniet me publikun pranë gjykatave themelore në mënyrë që të sigurohen të dhëna për ditën, vendin dhe kohën e mbajtjes së seancave ku gazetarët shfaqen si të akuzuar. Kështu, u identifikuan 148 raste aktive për periudhën 2007 deri në 2010, para Gjykatës Themelore Shkup I Shkup.

Duke pasur parasysh se zbatimi i aktiviteteve të projektit kërkon krahasime të përshtatshme të rezultateve të arritura nga projekti "shpifje dhe ofendim në procedura penale ndaj gazetarëve", zbatuar nga Koalicioni në 2006, filloi sigurimi i informatave shtesë, gjegjësisht u dërgua kërkesë deri te Ministria e Drejtësisë e Republikës së Maqedonisë në mënyrë që të merren treguesit përkatës statistikorë për numrin e procedimeve penale kundër gazetarëve gjatë periudhës 2006 – 2010. Ministria ndihmoi në identifikimin e procedurave penale kundër gazetarëve në vitin 2010 të cilat zhvillohetn para gjykatave themelore në RM³.

Në bazë të informatave të marrura nga gjykatat themelore, situata reale është si vijon: në gjykatën themelore në Kratovë udhëhiqen dy procedura kundër gazetarëve për shpifje dhe ofendim, në gjykatën themelore në Negotinë është e iniciuar një procedurë penale për shpifje, në gjykatën themelore në Shtip janë identifikuar 3 raste kundër gazetarëve për vepra shpifje, në gjykatën themelore në Kumanovë dhe Tetovë udhëhiqet një procedurë penale ndaj gazetarit për veprën penale shpifje, dhe në gjykatën themelore në Manastir gjithashtu është regjistruar vetëm një rast kundër gazetarit i cili ka qenë i akuzuar për shpifje dhe situata është identike para gjykatave në Ohër dhe Gostivar (një lëndë aktive);


Kundrejt kësaj, para gjykatave themelore në Prilep, Dellçevë, Kriva Pallankë, Sveti Nikollë, Kavadar, Kërçovë, Gjevgjeli, Vinicë, Koçan dhe Krushevë nuk udhëhiqen procedura penale ndaj gazetarëve për shpifje dhe ofendim Gjykatat themelore Shkup I, Shkup, Resnjë, Strumicë, Radovish, Dibër, Strugë, Veles dhe Berovë nuk dhanë përgjigje lidhur me kërkesën për qasje të lirë në informata publike mbi veprat penale shpifje dhe ofendim dhe për procedurat penale të mgritura kundër gazetarëve. Përkrah të sipërpërmendurës, të dhënat për hulumtimin u siguruan nëpërmjet komunikimit të rregullt dhe të vazhdueshëm me mediat, si dhe Shoqatës së gazetarëve të Maqedonisë për të

² Projekti është mbështetur financiarisht nga Misioni i OSBE-së në Shkup, dhe u zbatua në periudhën 15 janar - 30 nëntor, më shumë detaje tek Shpifja dhe Ofendimi në procedurat penale ndaj gazetarëve, Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë", Shkup, dhjetor 2006

³ Kërkesa për qasje të lirë në informata të karakterit publik ishte dërguar në Dhetor të vitit 2010.

prezantuar projektin aktual, dhe të ndihmës së ndërsjellë dhe bashkëpunimit në zbatimin e tij⁴.

Pas identifikimit u krye monitorimi i proceseve penale para gjykatave në katër gjykata themelore edhe atë: Gjykata Themelore Shkup I Shkup, Gjykata Themelore në Kumanovë, Tetovë dhe Manastir. Nga gjithsej 165 raste të identifikuara, gjatë zbatimit u monitoruan 77 lëndë dhe mund të konstatohet se:



- Numri i të akuzuarve në rastet e anketuara ishte 120, me çka duhet të merret parasysh se në disa nga rastet e vëzhguara, ka më tepër të akuzuar;
- 64 padi janë parashtruar ndaj gazetarëve për shpifje (83,1%), 2 lëndë për ofendim (2.6%) dhe 11 lëndë (14.3%) për shpifje dhe ofendim 5;
- Gazetarët dhe redaktor shfaqen në cilësinë e të akuzuarve në 6 lëndë apo 5%;
- Në 33 raste të lëndëve të vëzhguara është ngritur padi ndaj redaktorëve kryesorë dhe përgjegjës (27, 5%);
- Në pjesën tjetër të rasteve të monitoruara në cilësinë e të akuzuarit paraqiten personat si: honorarë (3,33%), udhëheqës (1,67%), menaxher (1,67%), person juridik (7.5%) dhe në kategorinë e personave të tjerë bejnë pjesë 5,83%

⁴ Të dhënat nga gjykatat themelore janë siguruar në bazë të letrave të dërguara dhe përgjigjet nga ato. Letrat janë dërguar në muajin Tetor 2010.

⁵ Eshhtë me rëndësi të theksohet se disa padi private janë parashtruar për shpifje dhe ofendim bashkërisht ose ndarazi.

Për çdo sesion të vëzhguar, ekipet vëzhguese plotësuan një pyetësor dhe të njëjtin e dërguan deri te koordinatori i projektit.

Së fundi, u bë përpunimi statistikor dhe analiza e të dhënave të siguruar gjatë projektit, dhe si rezultat i saj është e përgatitur edhe ky raport i cili e mbulon periudhën tetor 2010 – korrik 2011.

KAPITULLI I

MBROJTJA JURIDIKE E LIRISË SË SHPREHJES – DILEMA DHE SFIDA BASHKËKOHORE

1. *Liria e shprehjes si e drejtë themelore e njeriut*

"Zotëri, nuk i ndaj opinionet tuaja, por do të kisha rrezikuar jetën për të drejtën tuaj për ti shprehur".

Walter (1694 - 1778)

Liria e mendimit dhe shprehjes, duke përfshirë "lirinë për të marrë dhe dhënë informacione dhe ide nëpërmjet çfarëdo mediumi dhe pavarësisht nga kufijtë" është një nga të drejtat themelore civile dhe politike, e themeluar në instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Retrospektiva historike na afron me bindjet më të vjetra të cilat datojnë nga shekulli XVIII dhe XIX, kurë lufta për liritë personale dhe të drejtat për herë të parë, fitoi bazë ligjore në kushtetutën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të njëjtën linjë janë zgjidhjet e bazuara në aktet kushtetuese të shteteve evropiane⁶.

Filozofi britanik Xhon Stjuart Mill, në veprën e tij "Për lirinë" 1859, lirinë e shtypit e rëndit në mesin e "garancive themelore për të siguruar mbrojtjen kundër shtypit të korruptuar dhe qeverisë trane." Por ajo njëkohësisht paraqet të drejtë konsituive për një sistem demokratik në të cilin ekziston një e drejtë e garantuar për çdo individ (dhe jo vetëm qytetarët e një shteti!) për të shprehur mendimin e tyre dhe kritika në lidhje me pushtetin publik.

Shfaqja e mediave të para të shtypit është e lidhur me imperatorin më të famshëm francez Napoleon Bonapartën, i cili duke u ankuar për rrezikun e mediave për të arritur objektivat ushtarake, tregon rrezikun e (keq) përdorimit të lirisë së shtypit të vendosura në këto korniza. Sipas tij, "gazetari është llafazan, cenzor, udhëheqës me sundimtarin dhe tutor i kombit. Më shumë duhet të frikësohemi nga katër gazeta armiqësore se nga një mijë bajoneta!"

Liria e shprehjes ho vetëm që është një *conditio sine qua non*, dmth kusht pa të cilin nuk mund të ketë zhvillim intelektual dhe shpirtëror të çdo individi, por edhe më shumë, llogaritet ndër kushtet kryesore që përcaktojnë mbijetesën e shoqërisë⁵.

⁶ Kushtetuta e parë e cila e trajton lirinë e shprehjes së fjalës si parim juridik është Kushtetuta e Virgjinisë e vitit 1776, Kiprijanovska, Disa aspekte të së drejtës së shprehjes së lirë dhe mbrojtja e saj, Përmbledhje tekstesh në nder të prof. dr Todor Xhunov, Fakulteti juridik :Justiniani i parë", Shkup, 2009, f.820.

⁷ Mill, On liberty (1859), Penguin Classics, 1985, f. 76.

⁵ Alaburić, Sloboda izražavanja u Republici Hrvatskoj, Priručnik o slobodi javne riječi (COLIVER, Sandra, DARBSHIRE, Helen i BOŠNJAK, Mario, ur.), Article 19, London, i Press Data, Zagreb, 1998., ff 6. dhe 7

2. Aktet ndërkombëtare dhe standardet për mbrojtjen e lirisë së shprehjes

Pika e fillimit në formësimin e zgjidhjeve normative në legjislacionet kombëtare të shteteve dhe masat e krijimit të mjeteve të përshtatshme për të mbrojtur lirinë e shprehjes, duke përfshirë të drejtën në qasje dhe transferim të informacionit, paraqesin norma dhe standarde ndërkombëtare me çka detyrimin për ti mbrojtur të drejtat e garantuara e çojnë në nivel supranacional duke kërkuar miratim konsensual dhe harmonizimin e mëtejshëm të sistemeve kombëtare të shteteve.

Liria e shprehjes është e rregulluar në një numër të madh të instrumenteve ndërkombëtare. Të tilla janë, për shembull, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (neni 19)⁸, Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (neni 19, paragrafi 2)⁹, duke përfshirë edhe rezolutën 12/16 të miratuar nga Këshilli për të Drejtat e Njeriut pranë OKB-së¹⁰. Rezoluta imponon një kërkesë për shtetet - shtetet të përmbahen nga çdo kufizim i kësaj së drejte, e cila nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe dispozitat e KNDPCP (neni 19 paragrafi 3), sidomos kur është fjala për diskutime dhe kritika politikave qeveritare dhe shoqërisë - debate politike, raporte për të drejtat e njeriut, veprimtaritë e qeverisë dhe korrupsioni në aparatin shtetëror, përfshirjen dhe pjesëmarrjen aktive në fushatat zgjedhore, demonstrata paqësore, protesta publike dhe aktivitete politike e të tjera^{11 dhe12}.

Dokumenti i fundit i OKB-së me të cilin detajisht interpretohet çështja e sipërpërmendur është Komentari i përgjithshëm nr. 34 i miratuar nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut më 21 korrik, 2011 (neni 19)¹³. Ajo në mënyrë specifike rregullon çështjet e mëposhtme: lirinë e mendimit dhe të drejtën e shprehjes së lirë, lirinë e shprehjes dhe mediave, të drejtën e qasjes në informata, lirinë e shprehjes dhe të drejtat politike, zbatimin e dispozitës së nenit 19 paragrafi 3 i ICCPR; bazat për kufizimin e lirisë së shprehjes në fusha të caktuara, duke përfshirë edhe marrëdhëniet në mes të lirisë së mendimit dhe të shprehjes dhe nenit 20 nga ICCPR i cili ndalon propagandën në favor të luftës, si dhe çdo konspiracion për përhapjen e urrejtjes kombëtare, racore ose fetare - që nxit diskriminim, armiqësi ose dhunë.

⁸ „Secili ka të drejtë në liri të mendimit dhe shprehjes. drejtë përfshin edhe të drejtën e përfaqësimit të mendimit të caktuar pa asnjë ndërhyrje, të drejtën e kërkimit, pranimit dhe dhënies së informatave dhe ideve nëpërmes medimeve dherësisht nga kufijtë“.

⁹ „Secili ka të drejtë në shprehje të lirë pavarësisht kufijve ku nënkuptohet edhe e drejta në mbledhje, pranim dhe përhapje të informative dhe ideve në mënyrë të shkruar, me gojë, nëpërmjet shtypit dhe formave artistike ose në çfarëdo mënyre tjetër“.

¹⁰ Këshilli për të drejtat e njeriut pranë OKB-së është formuar me rezolutën nr. 60/251 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në vitin 2006.

¹¹ UN Docs: A/HRC/RES/12/16. Freedom of opinion and expression. Oct. 2009, para. 5 (f) 1

¹² Dokumentet tjera ndërkombëtare të cilat kanë të bëjnë me këto çështje gjenden në adresën: [http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/media/doc/dh-mm\(2000\)001_EN.asp#P748_120025](http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/media/doc/dh-mm(2000)001_EN.asp#P748_120025)

¹³ <http://www2.ohchr.org/english/bodies/hrc/docs/GC34.pdf>

Dokumentet e miratuara nga Bashkimi Evropian, do të përmendnim Kartën e të Drejtave Themelore të Njeriut. Neni 11 përmban formulimin vijues: "Çdo njeri ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe të drejtën për të marrur dhe shpërndarë informata dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve shtetërore dhe pa marrë parasysh kufijtë. Liria dhe pluralizmi i mediave do të respektohen."

Edhe Këshilli i Evropës gjatë kohë alarmon mbi nevojën për mbrojtje dhe promovim të së drejtës e shprehjes së lirë. Në këtë drejtim, janë ndërmarë hapa të rëndësishëm nëpërmjet miratimit të një numri të dokumenteve përkatëse në lidhje me çështjen qendrore. Në vitin 1982, Komiteti i Ministrave miratoi një Deklaratë mbi lirinë e shprehjes dhe informacionit dhe posaçërisht vuri në dukje rëndësinë e lirisë së shprehjes, si një instrument i nevojshëm për zhvillimin social, ekonomik, kulturor dhe politik të çdo individit, duke theksuar nevojën për krijimin e kushteve për progress harmonik të grupeve shoqërore dhe kulturore si dhe të bashkësisë ndërkombëtare në përgjithësi me rekomandimin. R (2002) 2 për qasje në informata zyrtare të miratuara në vitin 2002¹⁴, për herë të parë janë themeluar standardet rajonale për qasje në informata të përmbajtura në dokumentet me të cilat disponojnë organet shtetërore. Njëkohësisht inkurajohet pjesëmarrja në informim e publikut në lidhje me çështjet në interes të përbashkët, nxitet efikasiteti i administratës dhe në të njëjtën kohë, tregohet ndihmë e duhur në mbajtjen e integritetit të tyre duke shmangur rrezikun nga korrupsioni¹⁵.

Këtu, do të përmendnim edhe rekomandimin R (94) 13 të Komitetit të Ministrave për të nxitur transparencën e mediave. Ky rekomandim është i drejtuar qeverive të vendeve anëtare – shteteve, nga të cilat pritet të marrin masa të përshtatshme në legjislacionet kombëtare të cilat do të mundësojnë promovimin dhe garantimin e transparencës së mediave¹⁶.

Hapi tjetër drejt forcimit të kornizës mbrojtëse në këtë sferë është bërë me miratimin e Deklaratës për lirinë e debatit politik në media në vitin 2004¹⁷. Në të proklamohen parimet themelore në lidhje me shpalljen e informatave dhe mendimeve për figura politike dhe bartësve të funksioneve publike në media. Në pyetje janë parimet e mëposhtme: liria e shprehjes dhe informimit nëpërmjet mediave, liria e kritikës së shtetit apo institucioneve publike, debati publik dhe mbikëqyrja e zyrtarëve publik dhe politikanëve, lirinë e satirës,

¹⁴ Recommendation Rec(2002)2 of the Committee of Ministers to member states on access to official documents, <https://wcd.coe.int/wcd/ViewDoc.jsp?id=262135&Site=CM>

¹⁵ Rekomandimi parashëf qasje deri te dokumentet zyrtare me të cilat disponojnë organet shtetërore, pa diskriminim, me cka e drejta e sipërpërmendur mund ti nënshtohet kufizimit vetëm në raste të caktuara, të parapara me ligj, kur janë në pyetje interesat e sigurisë shtetërore, mbrojtjes dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, privatësisë dhe të drejtave tjera legjitime, udhëheqja e hetimit dhe ngritja e akuzës për vepër penale, interesa komerciale dhe interesave të tjera pavarësisht a janë ato private apo publike, barazia e palëve gjatë procedurës etje.

¹⁶ Recommendation No. (94) 13 on measure to promote media transparency, http://www.ebu.ch/CMSImages/en/leg_ref_coe_r94_13_transparency_221194_tcm6-4266.pdf

¹⁷ Declaration on freedom of political debate in the media, http://www.ebu.ch/CMSImages/en/leg_ref_coe_decl_political_debate_120204_tcm6-11947.pdf

reputacionit dhe të drehta të tjera të politikanëve dhe bartësve të funksioneve publike. Disa vjet më vonë, Komiteti i Ministrave pranë KE miratoi Konventën mbi qasje në dokumente zyrtare¹⁸.

Megjithatë, rol kyç në këtë fushë ka Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila me ratifikimin u imponohet gjykatave kombëtare, jo vetëm me autoritetin por mbi të gjitha me efikasitetin e mekanizmit mbrojtës. Jurisprudenca e pasur dhe respektive e institucioneve në Strasburg, e drejta e lirisë së shprehjes është e vendosur në nenin 10 të Konventës ku përfshihen komponentet bazë që kanë të bëjnë me përmbajtjen e të drejtave të garantuara, formës të së shprehurit dhe kufizimet e parapara.

E vendosur në këtë kontekst, liria e shprehjes nuk vlen vetëm për pozicionin e shkruar ose të thënë, por edhe për idetë, vizatimet dhe veprimet me të cilat mund të shprehet një ide e caktuar. Përveç përmbajtjes, dispozita mbron formën e shprehjes - media, vizatime, filma, komunikim në internet dhe transmetim elektronik të informacioneve dhe të ngjajshme¹⁸. Në kontekstin e çështjes qendrore, është e rëndësishme të theksohet se Gjykata Evropiane, shpesh herë, në vendimet e saja thekson qëndrimin se mediat janë një lloj monitoruesi permanent dhe korrigjues të pushtetit në një shoqëri demokratike. Sipas kësaj pikëpamje, gjykata cakton korniza të ngushta për vlerësim të lirë nga ana e shteteve, kur është fjala për sende që ndikojnë ose prekin lirinë e shprehjes të gazetarëve¹⁹.

3. Bazat e lejuara për kufizimin e lirisë së shprehjes

Është e padiskutueshme se nxjerja e disa informata në disa raste mund të shkaktojë dëm serioz për shoqërinë, prandaj edhe egziston obligimi i shtetit për të krijuar mekanizma të duhur mbrojtës të cilat do të parandalonin situata të tilla. Të gjitha instrumentet mbi të drejtat e njeriut, më shumë ose më pak, parashofin baza identike për kufizimin e kësaj së drejte dhe të njëjtën provë tripalëshe për përcaktimin e nevojës dhe ligjshmërinë e vendosjes së kufizimeve të tilla në gëzimin e së drejtës së lirisë së mendimit dhe të shprehjes (kështu, të Deklaratës Universale e të Drejtave të Njeriut, neni 29; Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, neni 19 (3) Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Neni 10 par. 2).

Megjithatë, duket që dispozitat e përmbajtura në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut caktojnë listën e kufizimeve të mundshme, në bazë më të gjerë dhe çka është me rëndësi të veçantë, karakterizohen me saktësi më të madhe.

¹⁸Konventa është miratuar me 27 nëntor 2008; teksti i dokumentit të sipërpërmendur mund të gjindet në <https://wcd.coe.int/wcd/ViewDoc.jsp?id=1377737&Site=CM>

¹⁸ Makovei, Udhërrëfyes për implementimin e nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Këshilli i Evropës, 2001, f. 9.

¹⁹ E drejta e lirisë së mendimit dhe shprehjes, mbledhjes së qetë dhe bashkimit, standard dhe praktika ndërkombëtare dhe nacionale, Instituti për të drejtat e njeriut, 2010, ff. 44 – 45.

Kështu, në paragrafin 2 të nenit 10 përcaktohet se kjo e drejtë mund të jetë subjekt i formaliteteve të caktuara, kushteve, kufizimeve dhe sanksioneve të parashikuara nga ligji, të cilat në një shoqëri demokratike paraqesin masa të nevojshme për sigurimin kombëtar, integritetin territorial dhe të sigurinë publike, mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e trazirave apo kimit, mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, reputacionit ose të drejtave të të tjerëve, parandalimin e shpërndarjes ose ruajtjes së autoritetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit. Asnjë e drejtë tjetër nuk përmban aq listë të gjatë të arsyeve për përjashtime.

Megjithatë, ajo duhet të plotësohen disa parakushte kryesore për kufizimin e së drejtës që e njejta të konsiderohet si legjitime 20. Në pyetje janë kushtet e mëposhtme (përcaktues):

- 1 çdo kufizim duhet të jetë i përcaktuar me ligj;
- 2 kufizimet duhet të vendoset në drejtim të arritjes së ndonjëres nga qëllimet legjitime të parashikuara dhe
- 3 kufizimet, edhe pse duhet të ndjekin objektivat legjitime, ato të duhet të jenë të domosdoshme në një shoqëri demokratike dhe në përpjestim me veprimin që do ta shkaktonin (testi trepalësh)²¹.

4. Korniza ligjore nacionale

Liria e mendimit dhe shprehjes publike të mendimit në Republikën e Maqedonisë janë të përcaktuara në aktin më të lartë juridik - Kushtetutën. Neni 16 i Kushtetutës garanton lirinë e besimit, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit, ndërsa paragrafi 3 i të njëjtit nen garanton qasje të lirë në informata. Liria e shprehjes do të thotë liri të dërgimit, transmetimit dhe pranimit të informatave dhe është e vendosur dy-dimensionalisht:

- 1 liria negative, të liruar nga ndërhyrjet e autoriteteve publike dhe
- 2 liria pozitive, e cila ofron procedura të veçanta dhe mekanizma nëpërmjet së cilave mund të zbatohen lirshëm proceset e komunikimit si dërgimi, transmetimi dhe pranimi i informatave²².

Duke pasur parasysh se sipas nenit 118 të Kushtetutës, traktatet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën janë pjesë e rendit të brendshëm juridik dhe nuk mund të ndryshohen me ligj, ligjvënësit tonë i lihet hapsirë, të drejtën e lirisë së mendimit dhe shprehjes, duke theksuar sidomos bazat për kufizimin e tyre, ta harmonizojë në

²⁰ *Ibid.*

²¹ V. fusnotë 16, f. 20.

²² Tupançeski, Kiprijanovska, Medarski, shpifja dhe ofendimi – prej inkriminimit në dekriminalizimin, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, Shkup, 2009.

përputhje me dispozitat e KNDCP dhe KEDNJ të cilave iu është bashkangjitur edhe Republika e Maqedonisë dhe të cilat janë të zbatueshme edhe në sistemin tonë ligjor²³.

Parimet e shpallura kushtetuese fillojnë të konkretizohen nëpërmjet dispozitave që përmbahen në rregullat përkatëse ligjore, në një masë më të vogël ose më e madhe, prekin çështjen kryesore. Këtu, së pari do të theksojmë Kodin Penal (më shumë detaje mbi këto prezantime më poshtë), më pas, Ligjin për veprimtari radiodifuzive²⁴, Ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore¹⁹, Ligji për Punë të Brendshme²⁰, Ligji mbi qasjen e lirë në Informata të karakterit publik, duke përfshirë ligjin mbi kundërvajtje kundër rendit dhe qetësisë publike²¹.

Kodeksi i gazetarëve të Maqedonisë si një sistem i kompletuar i rregullave etike, përmban dispozita që rregullojnë mënyrën e kryerjes së profesionit të gazetarisë, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e tyre, por edhe përcakton ndalime të caktuara shkëlqja e të cilave mund të çojë përgjegjësi gazetarin para bordit të nderit të shoqatës së gazetarëve të Maqedonisë. Detyra themelore e gazetarëve është respektimi i së vërtetës dhe së drejtës të publikut për t'u informuar, në përputhje me nenin 16 të Kushtetutës. Roli i tyre është të mundësojë transmetimin e informacioneve, ideve dhe opinioneve si dhe të drejtën për komente. Respektimi i vlerave etike dhe standardeve profesionale në transmetimin e informacioneve, gazetarët janë të detyruar të veprojnë bona fide, objektivisht dhe saktësisht, duke u përpjekur të parandalojnë censurën dhe shtrembërimin e informatave. Thjeshtë, etikës gazetareske përfshihet në tri parime të thjeshta:

1. respektimi i së vërtetës;
2. nevoja për pavarësi dhe
3. kujdesi i madh për pasojat e botimit²².

Këtu shkurtimisht do të ndalemi tek roli i gjykatës kushtetuese të RM-së në lidhje me dispozitën e nenit 110 pika 3 e Kushtetutës në të cilën shprehimisht potencohet se gjykata kushtetuese, mes tjerash, mbron të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të qytetarëve në

²³ E drejta e lirisë së mendimit dhe shprehjes, mbledhjes së qetë dhe bashkimit, standard dhe praktika ndërkombëtare dhe nacionale, Instituti për të drejtat e njeriut, 2010, 27 - 28.

²⁴ Neni 4 i ligjit tregon në rëndësinë e së drejtës së lirisë së mendimit dhe shprehjes, me kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive sigurohet liria e shprehjes së lirë të mendimit, fjalimit, fjalimit publik dhe informimit publik.

¹⁹ „Organet e administratës shtetërore kanë obligim tu sigurojnë qytetarëve realizim efikas dhe të drejtë të të drejtave tyre kushtetuese dhe duhet ta informojnë publikun për punën e tyre (n. 4 dhe 9). Kjo e drejtë mund të kufizohet nga interesat e sigurisë nacionale. Njëkohësisht, ligji parashëf kycjen e publikut në përpilimin e ligjeve të cilat janë në kompetencë të tyre (n. 10).

²⁰ Dispozita nga neni 5 I ligjit për punë të brendshme, parashëf detyrimin e MPB-së sipas së cilës, ministria përkatëse është e obliguar qytetarëve të ju jep informata për çështje nga kompetenca e saj për të cilën ata janë të interesuar (p. 2). I njëjti ligj, megjithatë parashëf edhe kufizime të qasjes deri te informata të cilat në bazë të ligjit janë të përcaktuara sit ë klasifikuara pervec kurë janë mbushur kushtet e parapara me ligj të posaçëm (p. 3).

²¹V. neni 10 – 13 nga ligji

²² Më gjerë, Kodi i Gazetarëve të Maqedonisë, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

http://www.mim.org.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=88&Itemid=68&lang=mk

lidhje me lirinë e besimit, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit. Edhe rregullorja e gjykatës gjithashtu rregullon këto përgjegjësi në mënyrë që neni 56 parashikon se "vendimi i gjykatës kushtetuese për të mbrojtur liritë dhe të drejtat, përcakton nëse ka shkelje të tyre dhe varësisht nga ajo, anulon aktin individual, e ndalon veprimin me të cilin është bërë shkelja, ose refuzon kërkesën përkatëse.

Duke analizuar praktikën e deritanishme të gjykatës kushtetuese mund të vërehet se pavarësisht nga iniciativat e parashtruara nga qytetarët për të mbrojtur të drejtën e lirisë së shprehjes, ende nuk ka asnjë vendim në të cilën është vendosur që kjo e drejtë është shkelur dhe elaborohet qëndrimi i gjykatës kushtetuese në lidhje me mbrojtjen e këtyre të drejtave. Të gjitha këto iniciativa në lidhje me këto të drejta të parashtruara nga qytetarët janë refuzuar²³.

²³ Analiza e situatës "Liri në vend të frikës: Mbrojtja e së drejtës së tubimit paqësor dhe shprehja e protestës publike", Instituti për të Drejtat e Njeriut, QMBN, fq. 90-10, gjendet në : http://ihr.org.mk/~ihrorg/images/stories/ihr_analiza_pravo_na_izrazuvanje_i_zdruzuvanje.pdf

KAPITULLI II

SHPIFJA DHE OFENDIMI NË LEGJISLACIONIN POZITIV PENAL

1. *Nderi dhe reputacioni si objekt i mbrojtur në të drejtën penale*

1.1 *Për nevojën e mbrojtjes (penale) juridike të reputacionit*

Balansi mes të drejtave themelore të përcaktuara në nenin 10 të Konventës Evropiane dhe së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare, reputacionit dhe dinjitetit të individit mund të jetë në kolizion, e cila vë në pyetje egzistencën e të drejtave themelore të njeriut. Kjo, veçanërisht nëse merren në konsideratë sfidat bashkëkohore të shkaktuara nga tendencat e zhvillimit teknologjik, të cilat kanë vendosur një dritë të re çështjen e mbrojtjes së të drejtave themelore të çdo individit nga format e mundshme të abuzimit që sjell ashtu e quajtura epokë e informatike²⁴.

Në fotografinë e ndryshuar të sistemit të vlerave, liria e mediave hap një seri sfidash dhe çështjet që meritojnë kujdes. Megjithatë, ngelën konceptimi kryesor sipas së cilit ushtrimi i një të drejte nga individit, në çdo rast, nuk duhet të çenojnë ose kufizojë të drejtën e ndonjë personi tjetër. E kundërta do të thotë një vlerësim të ndryshëm, gjegjësisht ofrim i nivelit të ndryshëm të mbrojtjes të të drejtave të barabarta për çdo individ. Për këto arsye, nuk lejohet e drejta e lirisë së shprehjes të realizohet në mënyrë të tillë që, do të ishte një sulm mbi jetën private, reputacionin dhe dinjitetin e tjetrit.

Kushtetuta e RM-së në dispozitën e nenit 25, çdo qytetari i garanton respektimin e privatësisë së jetës personale dhe familjare, dinjitetin dhe reputacionin. Në të njëjtën kohë, dispozitat kushtetuese sigurojnë mbrojtje të lirisë dhe paprekshmërinë së korrespondencës së letrave dhe formave të tjera të komunikimit²⁵. Megjithatë, mund të konstatohet se në ndeshje me lirinë e shprehjes, jeta private është e mbrojtur në një shkallë më të gjerë, përkundër reputacionit dhe nderit të individëve, të cilat janë pjesë e pandashme e personalitetit të tyre. Nuk ka marrëdhënie ndërpersonale reale njerëzore, jeta të harmonizuar dhe të qëndrueshme sociale, pa rrespektuar personalitetin e njeriut dhe vlerat e saj! Për këtë arsye, janë me domethënie të veçantë veprat kundër nderit dhe reputacionit. Në të vërtetë, duke pasur parasysh nivelin e ndëshkimit ligjor, këto vepra janë ndër të ashtuquajturit krimin të lirë, të vendosur në kufirin e ulët të veprave penale por nga ana tjetër, duke marrë parasysh rëndësinë e tyre sociale, është e qartë se ato janë të

²⁴ Vendet shpesh, përpiqen të kufizojnë qasjen në media, për shkak të pikëpamjeve të kundërta dhe / ose të përmbajtjes që mund të përbëjnë një kërcënim serioz për politikën kombëtare (si dhe baza fetare ose morale). Duke pasur parasysh faktin se ka shumë internet faqe që ofrojnë materiale raciste dhe ksenofobike, dhe veçanërisht pornografi të fëmijëve.

²⁵ Amandamenti XIX „Gazeta zyrtare e RM-së nr. 107/05

renditura shumë të lartë, me çka me të drejtë anashkalojnë kërkesat aktuale që lëvizin drejt dekriminalizimit, me çka shumë shpesh u ekspozohen kritikave të ashpra.

Objekt i mbrojtjes të veprave të përfshira në kapitullin XVII të Kodit Penal është nderi dhe reputacioni. E drejta penale këtu është në tokë të rrëshqitshme dhe përballet me vështirësi që lindin në përcaktimin e këtyre nocioneve, sidomos në aspektin e nderit si një nga të drejtat më të ndjeshme (por edhe më pak të mbrojtura) ligjore²⁶. Për dallim nga nocioni i nderit që paraqitet si një koncept bazë, egziston bindje e përgjithshme se reputacioni rrjedh nga i njeiti nocion, i cili ka rëndësi sekondare (disa vlera të njeriut që fitohen me sjellje, punë, etj).

2. Rreullat e posaçme dhe kushtet për përgjegjësi për veprat shpifje dhe ofendim në legjislacionin kombëtar penal

Konform rregullave që zbatohen në legjislacionin kombëtar penal, për vepra të kryera me anë të gazetës ose publikime të tjera të shtypura, nepermjet radios, televizionit ose revistave filmike, përgjegjës është redaktori përgjegjës, gjegjësisht personi që e ka zëvendësuar në kohën e publikimit të informacionit në raste ku janë plotësuar supozimet e mëposhtme:

- deri në përfundimin e seancës kryesore para gjykatës së shkallës së parë, autori të ketë nglur i panjohur;
- kur ëinformacioni është botuar pa pëlqimin e autorit dhe
- kurrë në kohën e publikimit të informacionit ka pasur pengesa faktike ose ligjore për ndjekjen e autorit, që egzistojnë ende.

Përrjashtohet përgjegjësia e redaktorit përgjegjës ose personi që e zëvendëson atë, në qoftë se për shkaqë të arsyeshme nuk ka dirur për ndonjë prej rrethanave të lartpërmendura²⁷. Në rastet kur ekzistojnë rrethanat e përmendura, zgjidhjet ligjore parahofin përgjegjësi penale për botuesit, prodhuesin dhe shtypësin dhe shkojnë në drejtimin që vijon:

²⁶ Egzistojnë perspektiva të ndryshme dhe reciprokisht kontradiktore teorike të cilat përipiqen për të dhënë një kontribut të caktuar për përkufizimin e së njejtës. E përfaqësuar është gjerësisht pikëpamja mbi nderin si tërësi e të gjitha vlerave të njeriut si individ, por edhe si qenie shoqërore. Rrjedhimisht, secili ka të drejtë të trajtohet në mënyrë që të ua njohin vlerat e tyre themelore të njeriut. Për të ekzistuar shkelja e nderit është e mjaftueshme të ketë një zhvlerësim i vlerave themelore të njeriut në aspektin e nderit të caktuar me norma. Në këtë kuptim, Kodi Penal, pranon shkeljen personale të nderit, por vetëm si një rrethanë të rëndësishme për ndjekje penale (ndjekje penale për vepra kundër nderit ndërmerret me padi private!). më shumë detaje tek V. Kambovski, E drejta penale – pjesa e veçantë, botim i katërt, Shkup, 2003, fq. 106.

²⁷ Neni 26 nga KPM.

- Në favor të kësaj teze, janë edhe ato të dhëna të cilat tregojnë se nga 7 rastet e vëzhguara, procedura përfundoi me marrëveshje mes palëve, më tej, janë regjistruar 18 raste ku është ofruar falje palës së dëmtuar, ndërsa falja është pranuar në 4 prej tyre dhe në disa prej rasteve gjyqtari e ka anuluar séance pasi është informuar se është në progres zgjidhja e saj me marrëveshje ndërmjet palëve;

4. (Mos) respektimi i standardeve për gjykim të drejtë

4.1 Gjykimi në afat të arsyeshëm

Gjykimi i drejtë ka një vend eminent në një shoqëri demokratike në kuptim të dispozitave të tekstit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ky dokument ndërkombëtar në mënyrë specifike parasheh garancinë për të pandehurin të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm kohor.

E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm është e përfshirë në nenin 6 par. 1 të Konventës, i cili konsiderohet të jetë më i gjërë, më kompleks dhe më fleksibël⁴⁶, por në të njëjtën kohë edhe më e shfrytëzuar qëllimi i së cilës është të sigurojë një gjykim të drejtë dhe fer duke pasur parasysh dispozitat e përgjithshme lidhur me procedurën penale, në përputhje me parimin e gjykimit brenda një periudhe të arsyeshme kohore.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet se arsyeshmëria që vlerësohet në secilin rast individual nuk mund të bëhet në abstracto, në parim dhe në përgjithësi, por duhet gjithmonë të merren parasysh rrethanat specifike të rastit në dritën e fakteve dhe rrethanave të veçanta të atij rasti⁴⁷. Edhe pse intervali i kohës së arsyeshme nuk është dhe nuk mund të jetë fiks, megjithatë, konsiderohet se ajo është një kohë e cila, të paktën, i kalon afatet e specifikuar në legjislacionet kombëtare të shteteve.

⁴⁶ Eissen, M. A., The length of civil and criminal proceedings on the case law of the European court of human rights, Council of Europe Publishing, 1996, 7//; така и O' Boyle, Warbick, Law of the European Convention of Human Rights, Butterwords, London, Dublin, Edinburg, 1995.

⁴⁷YBV, Xv. Belgium, f. 190, Mw gjwrwsisht Lazhëtiqj - Bužarovska, Vlerësimi i gjykimit brenda një kohe të arsyeshme përpara Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Vjetori i Fakultetit Juridik "Justiniani I" në Shkup, Vol. 41, 2004/2005.

Gjykata Evropiane nëpërmjet praktikës gjyqësore të saj, ka ngritur disa standarde të menaxhimit, të dukshme nëpërmjet analizës së vendimeve të saj. Veçanërisht të rëndësishme në këtë drejtim janë çështjet në lidhje me përcaktimin e fillimit dhe përfundimit të periudhës përkatëse të kohëzgjatjes së procedurës penale para gjykatave kombëtare dhe kriterëve të cilat konsiderohen të rëndësishme, dmth faktet dhe vëzhgimet mbi të cilat nxirret edhe përfundimi për (jo) arsyeshmërinë e periudhës përkatëse.

Në pyetje janë kriteret e mëposhtme:

- kompleksiteti i çështjes;
- sjellja e aplikantit;
- udhëheqja e rastit nga organet kompetente kombëtare dhe dëmi që i është shkaktuar aplikantit⁴⁸.

4.2 Cila është situata aktuale në jurisprudencën e brendshme në lidhje me respektimin e standardeve për gjykim në afat të arsyeshëm?

a) Një nga detyrat kryesore që janë vendosur para gjykatësit është për të siguruar drejtësi të ligjshme dhe efektive. Të ligjshme në drejtim përcaktimit të drejtë të fakteve relevante, duke përfshirë zbatimin adekuat të rregullave të së drejtës materiale, si dhe zgjidhjet procedurale. Efikasiteti nga ana tjetër, do të thotë arritjen e ligjshmërisë për një periudhë të shkurtër kohore me qëllim që subjektet që e kërkojnë, ta kenë atë mbrojtje ligjore sa më shpejt të jetë e mundur. Por shumë shpesh e ligjshmëria dhe drejtësia nuk arrijnë bashkimin e tyre. Gjithnjë e më shumë, duket që këto dy parime mes veti përjashtohen.

Veprimi në përputhje me rregullat për gjykim brenda një kohe të arsyeshme, paraqet një garanci thelbësore të sigurisë ligjore të çdo qytetari⁴⁹. Ligjshmëria dhe efikasiteti juridik në "kuptimin plotësues" ka një vlerë thelbësore ligjore dhe politike⁵⁰.

b) Edhe pse krejt kjo e lartpërmendura u sjell si rezultatet i hulumtimit, para nesh parashtrohet pyetja themelore nëse dhe deri në çfarë mase në legjislacionin maqedonas respektohen standardet për gjykim brenda një afati të arsyeshëm?

Vetëm një kujtesë, me ndryshimet në Ligjin mbi Gjykatat të vitit 2008,⁵¹ në fushëveprimin e kompetencave të Gjykatës Supreme, ndër të tjera, është edhe përgjegjësia për të vendosur sipas kërkesave nga palët dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurë për shkeljen e së drejtës për gjykim në kohë në procedurë të parashkuar me

⁴⁸ *Ibid.*

⁴⁹ Radolović, A., Zaštita prava na suđenje u razumnoj roku, Zb. Prav. fak. Sveuč. Rij., 2008, V. 29., Br. 1, f. 6.

⁵⁰ Така и Justiz – Recht – Staat, Wien, 2002, f. 8.

⁵¹ Gazeta zyrtare e RM, nr. 35/08

ligji para gjykatave në Republikën e Maqedonisë në pajtim me rregullat dhe parimet e determinuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁵².

Pala e cila beson se gjykata ka shkelur të drejtën për gjykim brenda një kohe të arsyeshme, ka të drejtë të aplikojnë për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë. Dispozitat e mëtejshme të ligjit përcaktojnë periudhën, përmbajtjen e kërkesës, mënyrën e veprimit dhe vendosjes nga gjykata dhe parashtrimin e ankesës në rastet kur pala në procedurë është e pakënaqur me vendimin e gjykatës⁵³.

Së fundi, nëse i përcjellim të dhënat nga anketa mund të nxirren përfundimet e mëposhtme:

- Duke i marrë parasysh faktorët që ndikojnë në kohëzgjatjen e procedurës në lidhje me procedurat gjyqësore për vepra shpifje dhe ofendim, domosdoshmërisht duhet të theksohet performanca e dobët e sistemit të gjyqësor penal, e cila është konfirmuar nëpërmjet analizave të të dhënave të marra nga anketa të cilat tregojnë se egzistom një periudhë e gjatë që nga koha kur paditësi privat ka vendosur të nisë një përndjekje penale për shkelje të të drejtave të tij (në këtë rast, reputacionin dhe nderin) deri te caktimi i seancës së parë nga gjykata;
- Për fat të keq, ende nuk mund të haste në raste të tilla në të cilat koha e pritjes nga paraqitja e padisë private për shpifje dhe / ose ofendim deri në caktimin seancën së parë është më shumë se 300 ditë;
- Anulimi i gjykimeve si një nga faktorët e rëndësishëm që ndikojnë në zvarritjen e procedurës, paraqet një dukuri po thuajse të rregullt në jurisprudencën e brendshme;
- Edhe ndërprerja e seancës kryesore, veçanërisht pasi që punohet për vepra për të cilat ka një procedurë të shkurtuar, haset gjithashtu në disa raste të analizuara (në gjithsej 11 raste);
- Në këtë drejtim, është e këshillueshme për qasje dhe mendim serioz të në krijimin e mundësive të favorshme për zbatimin e vendimeve të reja penale procedurale kur është fjala për veprat shpifje dhe ofendim duke marrë kryesisht në konsideratë "cilësinë juridiko penale e jo së drejtës", kur është fjala për këto vepra të cilat përfshihen në kategorinë e krimit të lirë dhe kërkesat për klasifikim të jo së drejtës;
- Kjo, në fund të fundit, duhet të kontribuojë në arritjen e të drejtave themelore të palëve të përfshira në procedurë, por edhe të ndikohet në drejtimin e shkarkimit

⁵² Neni. 35 p. 5 nga LGJ.

⁵³ Nenet. 36, 36 – a dhe 36 – b nga LGJ.

të punës së gjykatave nëpërmjet të të ashtuquajturave mjete ndihmëse, duke marrë parasysh mbingarkesën e tyre.

4.3 E drejta për pjesëmarrje efektive në procedurë penale

Një nga elementet që e përbëjnë konceptin e gjykimit të drejtë (edhe pse nuk përmendet shprehimisht në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut), është e drejta e të akuzuarit për të marrë pjesë efektivisht në procedurën e filluar kundër tij. Rëndësinë e sigurimit të mbrojtjes në procedurë penale është e identifikuar si parim themelor në një shoqëri demokratike, kështu që në këtë kuptim, neni 6 i Konventës duhet të interpretohet në një mënyrë që do të sigurojë zbatimin praktik dhe efektiv të të drejtave, duke menjanuar çdo rrezik i cili mund ti sjellë në nivelin e ideve teorike dhe iluzore⁵⁴. Nga shtetet pritet të jenë vigjilente në sigurimin e të drejtave të mbrojtjes dhe marrjes së masave që do të paraqisnin një lloj kufizimi të këtyre të drejtave, zbatimi i këtyre masave duhet të jetë absolutisht i nevojshëm⁵⁵

Në disa raste Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka njohur të drejtën e të akuzuarit për të marrë pjesë në mënyrë efektive në procedurë. Kjo kryesisht nënkupton praninë e të akuzuarit gjatë gjykimit, " nga nocioni i gjykimit të drejtë del se një person i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë të merr pjesë në gjykim, dmth gjatë procedurës të inicuar kundër tij⁵⁶.

Nga këtu del se shteti ka detyrim pozitiv për të marrë hapa drejt sigurimit të së drejtës tradicionale nga ana e të akuzuarit. Njoftimi me kohë i të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij për seancën gjyqësore është një nga hapat kryesorë të cilat domosdo të merren duke pasur parasysh aspiratën për arritjen e standardeve themelore⁵⁷.

Nga e drejta për të qenë i pranishëm në gjyq i akuzuari mund të heqë dorë, por vetëm nëse ajo është e qartë dhe pa mëdyshje. Mbetet, që autoritetet shtetërore për të demonstruar se i akuzuari i cili ka munguar ka qenë i vetëdijshëm për procedure e udhëhequr kundër tij dhe se janë ndërmarrë hapat e duhura për të gjetur atë⁵⁸.

⁵⁴ B. Artico v. Italy, Series A No. 37, para. 33.

⁵⁵B. Van Mechelen v. Netherlands, 23. 04. 1997, R.J.D., 1997-III, para.58 – Rasti i dëshmitarëve anonimë. Nwse wshtw e mjaftueshme masa mw e vogwl kufizuese, atëherë kjo masë duhet të zbatohet, Kallajxhiev, Elemente të konceptit të gjykimit të drejtë tw cilat nuk janë përmendur shprehimisht në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Procedura për nder të prof. Dr Stefan Georgievski, Fakulteti i Drejtësisë "Justiniani", Shkup, 2010, fq. 695-711.

⁵⁶B. Ekbatani v. Sweden, No. 10563/83, 26.05.1988

⁵⁷ Nuk duhet, megjithatë, të lihet në harresë fakti se e drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk është absolute. Kështu, në rastin: Ensslin dhe të tjerët kundër Gjermanisë, 1978, 14 DR, 64 të akuzuarit nuk ishin në gjendje të marrin pjesë në faza të caktuara gjatë gjykimit, për shkak të grevës së urisë ata nuk kanë qenë në gjendje shëndetësore për të bërë këtë, cf.: Ensslin dhe të tjerët kundër FR Gjermani, 1978, 14 D.R., 64 Komisioni theksoi se në bazë të nenit. 6 p. 3 (c), gjykimi nuk mund të mbahet pa mbrojtjen, që të jetë në gjendje adekuate ti paraqesë argumentet e saj. Megjithatë, është konstatuar se "në rrethanat, gjyqtari ka mundur të përdorr mjetet në dispozicion, duke ndërprerë procedurën, pa e vendosur mbrojtjen në disavantazh për shkak mbrojtësit e të akuzuarve ikanë qenë të pranishëm dhe praktikisht kanë pasur mundësi të pakufizuara për të krijuar kontakte me klientët e tyre, Kallajxhiev, 2010, fq. 697-698.

⁵⁸ Colloza v. Italy, Judgment, 12.02.1985, Series A, No. 89, 7 EHRR, 516 sipas Kallajxhiev, 2010, f. 697 – 698.

4.4 Procedura dëshmuese

Në lidhje me parimin e barazisë së mjeteve dëshmuese, secila nga palët duhet të ketë një mundësi të arsyeshme për të paraqitur argumentet dhe provat në kushte që nuk do ti sjellin në pozitë të pabarabartë kundër palës kundërshtare. Në lëndët penale, mbledhja dhe paraqitja e provave është vërejtur në dritën e garancive të përmendura në paragrafin 2 dhe 3 të nenit 6 (dmth. prezumimi i pafajsisë e të drejtave dhe listës minimale të të drejtave të akuzuarit).

Në lidhje me paraqitjen e provave në gjyq, Gjykata e Strasburgut fillon nga qëndrimi se në princip të gjitha provat kundër të akuzuarit duhet të paraqiten në procedurë gjyqësore publike para gjykatës, me mundësi për debat kontradiktor. Gjykatat kanë obligim të sigurojnë që dëshmitë të prezantohen si duhet dhe në një procedurë të drejtë⁶⁹.

Rezultatet nga hulumtimi i realizuar në lidhje me çështjen që e shqyrtojmë çojnë drejt gjendjes së mëposhtme:

- Sipas të dhënave me të cilat disponon Koalicioni në lidhje me rastet në të cilat ka ardhur deri te prezentimi i dëshmvve, rezulton se në 12 raste të vëzhguara ka pasur pyetje të të akuzuarit;
- deklarata e viktimës janë haset në 11 raste;
- deklarata e dëshmitarëve si një ndër mjetet më të përdorura të provës haset në 4 raste;
- paraqitja e dëshmvve materiale në një farë mase, është e vendosur në një nivel më të ulët (7 raste);
- në paraqitjen e provave me shkrim – dokumente, është hasur në 5 prej rasteve të monitoruara dhe
- kategoria e dëshmvve tjera është në vendin e fundit, dmth pjesëmarrja e tyre është vërejtur vetëm në 1 rast.
- duke pasur parasysh të sipërpërmendurën, mund të konkludohet se dëshmia e të akuzuarit ende gëzon një vend qendror në veprimin e gjykatës kur është fjala për veprat shpifje dhe ofendim ku në statusin e personave të akuzuar shfaqen gazetarët dhe redaktorët përgjegjës dhe kryesorë.
- por deklarata e të akuzuarit e dhënë në procedurë nuk mund të vlerësohet si një dëshmi, megjithatë, të dhënat e fituara konfirmojnë se ajo paraqet një burim të rëndësishëm të të dhënave - fakteve në procedurë penale⁵⁹!

⁶⁹ Kallajxhiev, 2010, f. 695 – 711.

⁵⁹ Në procedurën tonë penale, pyetja e të akuzuarit nuk bie midis mjeteve të provave, sepse ajo është një proces që i shërben palës mbrojtëse, një nga tre funksionet themelore në procedurën penale. Në qoftë se ai pajtohet, mund të jetë një burim i të dhënave në procedurë, por kjo nuk do të ndryshojë pozicionin e tij dhe të dëgjuarit e tij nuk është dëshmi, por një veprim procedural që është ndërmarrë për të përcaktuar identitetin e të akuzuarit dhe mjet i cili e lejon të paraqesë mbrojtjen e tij, Nikolla Matovski, Lazhëtiq - Buzharovska Gordana, Gordan Kallajxhiev, 2009, fq. 236



4.5 Gjykimi në mungesë

Nëse respektohen disa garanci përkatëse, gjykimi në mungesë nuk do të konsiderohet shkelje të dispozitave përkatëse të Konventës. Megjithatë, nëse i akuzuari shfaqet, ai ka të drejtë të kërkojë rastin të rishqyrtohet⁶⁰. Në këtë kuptim, Gjykata Evropiane në Strasburg nuk e ka miratuar rregullën sipas së cilës, në Itali gjykimi i ri ishte i kufizuar në rastet kur i akuzuari ka mundur të dëshmojë se mungesa e tij gjatë procedurës nuk ka qenë një përpjekje për t'i ikur drejtësisë⁶¹. Por edhe në ato situata kur i akuzuari vetë zgjedh që të mungojë nga séance e caktuar, është e nevojshme të lejohet prania e avokatit të tij gjatë gjykimit. Mungesa e të akuzuarit nuk e liron nga ajo që të mund të përdor të drejtën themelore për përfaqësim nga avokati i tij⁶².


Nga të dhënat me të cilat disponon Koalicioni, mund të shihet se vetëm në dy raste të akuzuarit i është gjykuar në mungesë (ose 1.7%). Ka shenja të dukshme se në 66 raste të monitoruara, dmth 55% ka ardhur deri në shtyrjen e seancës për shkak se nuk kanë qenë të plotësuar kushtet për mbajtjen e saj në drejtim të pranisë së palëve, në këtë rast personi i akuzuar.

⁶⁰ B. K. STARMER, *European Human Rights Law*, LAG, London, 1999, 267.

⁶¹ B. Colloza v. Italy, Judgment, 12.02.1985, Series A, No. 89.

⁶²B. Poitrimol v. France, 1993, 18 EHRR, 130.

A gjykohen të akuzuarit në mungesë?



4.6 Tërheqja (anulimi) e padisë private

Dispozitat në Ligjin për procedurë penale parashofin disa mënyra për paditësin privat për të anuluar të njejtën edhe atë:


- qartë - kur paditësi privat me shkrim ose në procesverbal para gjykatës deklaron se heq dorë nga e drejta e tij për ankesë, ose
- heshturazi - në rastet kur ai nuk do të marrë pjesë në seancë, edhe pse është i thirrur në rregull ose ftesa nuk mund t'i dorëzohet për shkak të nddërrimit të adresës ose të banimit. Në këtë rast, supozohet se ai është indiferent për të ndjekur penalisht⁶³.

Nga të dhënat e mbledhura mund të vërehet se mungesa e paditësit privat paraqitet si arsye për "përfundimin" e procedurës në 3 raste të vëzhguara. Tërheqja e padisë ka edhe pjesëmarrjen e vet në këtë vend andaj situata është si vijon:

- në 7 raste, padisë private ka qenë e tërhequr në lidhje me të akuzuarin e parë;
- paditësi private ka tërhequr ankesën në lidhje me të akuzuarin e dytë në 5 raste të monitoruara që kanë pasur epilog gjyqësor dhe në fund
- Në 8 raste ankesa është tërhequr në tërësi.

⁶³ Neni. 54 p. 1 i LPP; më gjerë Nikolla Matovski, Lazhetiq - Gordana Buzharovska, Gordan Kallajxhiev, E drejta penale procedurale, 2009, Fakulteti Juridik "Justiniani i parë", Shkup, fq. 129

Në cilën pjesë është tërhequr padia




Megjithatë vlen të theksohet se për shumicën e rasteve, procedura është ende në vazhdim, prandaj ne nuk mund plotësisht të nxjerrim të dhëna përkatëse në këtë drejtim.

a) Pajtimi i palëve

Para caktimit të seancës kryesore për vepra penale nën autoritetin e një gjyqtari, gjyqtari individ mund të thërrasë vetëm paditësin privat dhe të akuzuarin në ditë të caktuar të vijjnë në gjykatë për mbajtjen e seancës për pajtim. Nëse nuk vjen deri te pajtimi i palëve dhe tërheqjes së padisë private, gjykatësi do të marrë deklaratë nga palët dhe do të bëjë thirrje atyre për të vënë propozimet e tyre në aspektin e mbledhjes së provave⁶⁴.

Në kontekstin e të dhënave nga hulumtimi, duhet të theksohet se pajtim mes të palëve është arritur në 7 raste edhe atë në dy raste ka pajtim gjyqësor, ndërsa në 5 raste të tjera ka pajtim jashtagjyqësor.

Çfarë lloji i pajtimit është arritur?



Ajo që meriton vëmendje të veçantë në këtë vend, ndër të tjera, flet në favor të formave të reja të veprimit jashta gjyqësor dhe zgjidhje të çështjeve penale. Shqyrtim i saj ishte imponuar me zgjidhjet e reja të LPP, qëllimi kryesor i të cilit është rirregullimi i rolit të

⁶⁴ Ibid, f. 413.

subjekteve procedurale, para së gjithash i palëve dhe mbrojtësit në procedurë, duke pranuar dispozitat e vullnetit të palëve dhe mbrojtësit si një parakusht për menjanimin e procedurës penale klasike, racionalizimi dhe zbatimi i drejtësisë penale. Tema jonë prek procedurën e ndërmjetësimit dhe pajtimit në mes të viktimës dhe kryesit të veprës, prandaj edhe egziston nevoja ti shqyrtojmë zgjidhjet e reja.

b) Ndërmjetësimi si një formë e përsheptimit të procedurës penale

Në shumicën e shteteve, praktika e ndërmjetësimit si një mjet për zgjidhjen e konfliktit ka rezultate pozitive. Në Francë, ndërmjetësimi dëshmon të jetë një metodë efektive që çon në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në 70% të rasteve në të cilat është zbatuar. Në SHBA, ku nuk ka kufizime në zbatimin e saj në rastin e krimeve të vogla (kundërvajtje) është zbatuar në 69, 8%, dhe në vepra të rënda penale (felonies) është përdorur në 30.1%. Në Gjermani gati 86% e shkelësve kanë treguar gatishmëri për të marrë pjesë në ndërmjetësim për pajtim me viktimën / palën e dëmtuar⁶⁵.

Në ligjin kombëtar, procedura e ndërmjetësimit mori vendin që i takon në dispozitat e Ligjit të ri për procedurë penale⁶⁶ aplikimi i së cilës është paraparë për rastet në të cilat bëhet fjalë për një krim për të cilin Kodi Penal parashikon dënim me burg prej pesë vjet - që janë të ndjekur me ankesë private dhe për të cilën mbahet procedurë e shkurtuar ku del rezultati se ndërmjetësimi është në të vërtetë një alternativë për procedurën e shkurtuar.

Megjithatë, të dhënat tregojnë se nga 18 raste në të cilat i akuzuari i ka ofruar falje palës së dëmtuar, ajo u pranua në 4 raste. Gjithashtu mund të vërehet se disa prej lëndëve që janë ende në vazhdim, seanca është shtyrë për shkak të raportimit të gjykatës se në process është pajtimi jashta gjyqësor midis palëve.



⁶⁵ Gordana Buzharovska, Misoski Boban, Ndërmjetësimi dhe marrëveshja, MRKPK, 16, nr. 2, 2009, f. 252.

⁶⁶ Aplikimi I ligjit të ri për procedurë penale është paraarë për janar të vitit 2012

REKOMANDIME

- Ndërmjetësimi si një mjet për pajtimin në mes palëve mund të jetë një zgjidhje efikase kur është fjala për vepra të cilat ndiqen me padi private.
- Inkriminimet nga nenet 172 dhe 173 hyjnë në grupin - dispozita për të cilat mund të aplikohet në praktikë ndërmjetësimi në përputhje me legjislacionin e ri.
- Në këtë kontekst, duket e përshtatshme, në periudhë e ardhshme të qasjemi të menduarit më seriozisht dhe të merren masa që do të mundësojnë zbatimin e suksesshëm të ndërmjetësimit, kur është fjala për veprat penale shpifje dhe ofendim.
- Kjo zgjidhje në një masë të konsiderueshme, mund të kenë efekte të shumta: nga njëra anë, ajo do të kontribuojë në lehtësimin e gjyqësorit kur është fjala për këto krime (sidomos duke pasur parasysh rritjen e krimit të organizuar dhe të teknologjisë lartë për të cilat kërkohet përpjekje serioze nga gjykata, me qëllim për të zbuluar dhe ndëshkuar autorët e këtyre veprave) dhe nga ana tjetër, praktika e saj mund të prodhojnë një ndikim pozitiv në drejtim të palëve të involvura në procedurë dhe anulimi i saj i tepruar.

5. Aktgjykimi, lloji i aktgjykimit dhe politikës e dënimit

Gjykimi i një mosmarrëveshje penale do të thotë vendosje për të gjitha çështjet e diskutueshme, sqarimin e tyre dhe determinimi i së vërtetës, në përputhje me faktet përkatëse. Aktgjykimi si një lloj vendimi me të cilën gjykata përfundon një rast (penal), jep përgjigje në pyetjen nëse i akuzuari ka kryer krimin dhe a është penalisht përgjegjës.

Për shkak se ndjekja penale për shpifje dhe ofendim inicohet në bazë të padisë private kundër atyre të akuzuarve për këto vepra mbahet procedure e shkurtër në të cilën gjykatësi është i obliguar që, pas përfundimit të seancës kryesore menjëherë ta shpallë vendimin dhe për ti publikojë arsyet thelbësore. Aktgjykimi duhet të bëhet me shkrim brenda tetë ditësh nga data e publikimit⁶⁷.


Çfarë mund të shihet nga lëndët e monitoruara, i referohet faktit se nga gjithsej 77 lën dë, aktgjykim është sjellë vetëm në 6 raste, duke përfshirë:

- aktëgjykim dënues nuk është sjellë në asnjë nga lëndët e monitoruara;

⁶⁷ Neni. 429 p. 3 nga LPP

- katër procedura penale kanë mbaruar me sjelljen e aktgjykimit lirues dhe
- aktgjykim me të cilin refuzohet padia është sjellë në 2 raste, në një prej tyre, vendimi refuzues është sjellë për mungesë të ndjekjes penale për shkak të vjetërsimit (neni 107 i Kodit Penal)⁶⁸.


Lloji i aktgjykimit për të akuzuarin?



Sa i përket shpalljes së aktgjykimit, mund të konkludohet si vijon:

- Në tre raste aktgjykimi është shpallur menjëherë dhe
- brenda (tre) rasteve të tjera gjykata mori përgjegjësinë për dorëzimin me shkrim të vendimit të sjellur.

Kurë është shpallur aktgjykimi?



⁶⁸ Vjetrim i ndjekjes penale është një rrjedhë e kohës, pasi që nuk mund të fillohet ose vazhdohet me ndjekjen penale, në lidhje me kufizimin e ndjekjes penale, gjykata duhet të kujdeset ex officio.

KONKLUZIONE

- Duke kërkuar për të shmangur përsëritjen e panevojshme të konkluzioneve të paraqitura më parë, përmbledhja përfundimtare tregon se ka për qëllim edhe një herë, qartë dhe saktë të tregojë për problemet e zbuluara gjatë vëzhgimit të procedurave gjyqësore në lidhje me veprat penale shpifje dhe ofendim, si dhe për faktorët - pengesat që rezultojnë në vonesa të procedurës, pjesëmarrjen e palëve në procedurë dhe rrethanat e tjera të dokumentuara të cilat duken të rëndësishme për studimin tonë.
- Në periudhën kohore tetor 2010 - korrik 2011 gjithsej janë monitoruar 350 seanca para katër gjykatave themelore edhe atë si vijon: Gjykata Themelore Shkup I, Gjykata Themelore në Tetovë, Manastir dhe Kumanovë;
- Nga totali i 165 rasteve të identifikuara gjatë zbatimit janë vërejtur 77 raste ku në cilësinë e të akuzuarit paraqiten 120 persona;
- Pas përpunimit dhe analizës statistikore të të dhënave të fituara, mund të konkludojmë si vijon:
 - përqindja më e madhe e lëndëve të vëzhguara janë për veprën penale shpifje nga neni 172, edhe atë 64 nga lëndët e vëzhguara kanë të bëjnë me të, ose rreth 53, 3%;
 - vepra penale ofendim paraqitet vetëm në 2 raste (1.7%);
 - përqindja e pjesëmarrjes së lëndëve për të cilat udhëhiqet procedurë penale për veprat shpifje dhe ofendim arrinë 9.2% ose 11 raste kanë të bëjnë me veprat e sipërpërmendura;
- Dilema të veçanta në nivelin teorik dhe atë praktik paraqest çështja e përgjegjësisë penale të personave juridik për vepra të tilla, pyetja në një farë mase shqyrtohet edhe në kontekstin e dispozitave të Kodit Penal që me ndryshimet e vitit 2009 japin mundësi të gjerë për sanksione për persona juridik;
- Rezultatet e anketës tregojnë se rastet penale kundër personit juridik për aktet shpifje dhe / ose ofendim marrin pjesë me 7.50%, pra mund të shihet nga totali në 9 raste të vëzhguara;
- Lidhur me pyetjen se çfarë intervali kohor ka kaluar nga koha e kryerjes së veprës penale deri në parashtrimin e padisë private, të dhënat në dispozicion tregojnë se kjo periudhë mesatarisht është rreth 48 ditë;

- Sa i përket profilit të paditësit privat, të dhënat e përfshira në pyetësorët për monitorim të rasteve paraqesin një foto reale se në secilin prej rasteve të monitoruara, roli i paditësit privat për këto vepra është "rezervuar" për bartësit e funksioneve publike, me cka edhe një herë vërtetohet teza se figurat publike të konsiderojnë se janë të ekspozuar shpesh kritikave nëpërmjet mjeteve të informimit dhe se janë sidomos "të ndjeshëm" në lidhje me të;
- ajo që ka shkaktuar shqetësim pas analizave të bëra ka të bëjë me çështjen e kohës nga parshtrimi i padisë private deri në caktimin e seancës së parë;
- përpunimi statistikor i të dhënave të siguruara tregojnë se kjo periudhë kohore mesatarisht është 145 ditë;
- shqetësuese është ajo se në praktikë, ende mund të gjenden raste të tilla në të cilat koha e pritjes kalon 300 ditë. Në një nga lëndët e vëzhguara seanca ka qenë e caktuar pasi kanë kaluar 340 ditë nga parashtrimi i padisë private;
- shtyrja e shpeshtë e seancave është një faktor i rëndësishëm që ndikon në zvarritjen e procedurës dhe hap çështjen e respektimit të standardeve për gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm.
- Monitorimi i rezultateve nga procesi monitories shprijnë deri te arsyet e mëposhtme për shtyrjen e seancave:
 - Mungesa e të akuzuarit ka pjesën më të lartë në foton e përgjithshme - në 106 seanca të vëzhguara, përpunimi i të dhënave të grumbulluara argumenton se në kuadër të të gjitha seancave të vëzhguara 350 seanca (77 raste) në lidhje me veprat për shpifje dhe ofendim, prania e të akuzuarit është siguruar me ftesë, në asnjë rast nuk ka pasur sjellë të detyrueshme me forcë;
 - Gjithsej 29 seanca janë shtyrë sepse paditësi privat nuk ka marrë pjesë në seancën caktuar;
 - Në 13 raste të vëzhguara, seanca është shtyrë për shkak të mungesës së avokatit;
 - Mungesa e palës së dëmtuar paraqitet në 8 raste;
 - Shtyerja e seancës për shkak të mungesës së dëshmitarëve është në vendin e fundit - të regjistruara janë vetëm 2 raste të tilla.
- Lidhur me çështjen e ndërprerjes së seancës kryesore, rezultatet tregojnë se numri i rasteve në të cilat a ardhur deri te ndërprerja e seancës kryesore është 11 (ose 3.1%). Arsyet për këtë janë:
 - përgatitja e mbrojtjes (në 4 raste);

- gjetja e provave të reja (gjithashtu në 4 raste);
 - pushim (2 raste) dhe
 - përgatitja e aktakuzës paraqitet si shkak për ndërprerjen e seancës kryesore në 1 prej rasteve që kanë qenë objekt i monitorimit.
- Rezultatet me të cilat disponon Koalicioni për gjithsej 28 lëndë të cilat përfundimisht me muajin korrik 2011, kanë pasur epilog gjyqësor, tregojnë që në asnjë nga këto lëndë nuk është shqiptuar gjobë për veprat shpifje dhe ofendim;
 - Treguesit statistikore tregojnë për faktin se vetëm në dy raste të akuzuarit u gjykuan në mungesë (ose 1.7%) Ka shenja e qartë se vërejtur në 66 raste, dmth 55% çoi në shtyrjen e seancës për shkak se ata nuk ishin kushtet për mirëmbajtjen e saj në drejtim të pranisë së një partie, në këtë rast personi i akuzuar.
 - Lidhur me çështjen e tërheqjes së ankesës, përpunimi statistikor i të dhënave tregon situatën e mëposhtme:
 - në 7 raste padia private ka qenë e tërhequr në lidhje me të akuzuarin e parë;
 - paditësi privat ka tërhequr padinë në lidhje me të akuzuarin e dytë në 5 raste të cilat kanë pasur një epilog gjyqësor dhe
 - në 8 raste padia është tërhequr në tërësi;
 - Pajtimi në mes të palëve është arritur në 7 raste, duke përfshirë:
 - në dy raste pajtimi gjyqësor, ndërsa
 - në 5 rastet tjera ka pasur pajtim jashtëgjyqësor;
 - te lëndët që ende janë në procedurë e sipër, gjyqtari ka shtyrë seancën, sepse nga avokati i paditësit ka qenë i informuar se në process është zgjidhja jashtagjyqësore ndërmjet palëve;
 - Të dhënat tregojnë se nga 18 rastet në të cilat i akuzuari ka ofruar falje palës së dëmtuar, është pranuar në 4 raste.
 - Nga lëndët e monitoruara mund të konkludohet se nga gjithsej 77 lëndëj, është sjellur aktgjykim vetëm në 6 raste, duke përfshirë:
 - aktgjykim dënues nuk është sjellë në asnjë nga lëndët e monitoruara;
 - katër procedura penale janë kryer me sjelljen e aktgjykimit për lirim dhe
 - aktgjykimi për refuzimin e aktakuzës është bërë në dy në 2 raste, me çka në një prej tyre, vendimi refuzues është dhënë për shkak të mos egzistimit të mundësisë për ndjekje penale për shkak të vjetërsisë;

- Lidhur me shpalljen e aktgjykimit, situata është si vijon:
 - në tre raste aktgjykimi është shpallur menjëherë
 - brenda (tre) rasteve të tjera gjykata ka marrë përgjegjësinë për dorëzimin me shkrim të aktgjykimit të sjellë.

REKOMANDIME

- Të gjinden zgjidhje të përshtatshme që do të mundësojnë shkurtimin e intervalit kohor nga paraqitja e padisë private deri në caktimin e seancës së parë kur bëhet fjalë për veprat penale shpifje dhe ofendim;
- Marrja e masave të përshtatshme që do të mundësojnë parandalimin e vonesave të panevojshme, si një faktor i rëndësishëm që ndikon në zvarritjen e procedurës dhe në të njëjtën kohë hap çështjen e respektimit të standardeve për gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm;
- Bartësit e funksioneve publike janë shpesh subjekt i kritikave të forta publike nëpërmjet mediave, por kjo nuk mund të shërbejë si arsytim i mjaftueshëm për paraqitjen e aq padive private për shpifje dhe ofendim nga ana e tyre. Në vend të inicimit të proceseve gjyqësore, është e pëlqyeshme që këto njerëz të tregojnë një shkallë më të lartë të tolerancës ndaj kritikës publike.
- Përgjegjësia penale e mediave si persona juridikë dhe sanksionimi i tyre për veprat e shpifjes dhe ofendimit meriton vëmendje të veçantë në këtë vend, kështu që në këtë kuptim duhet të kemi një qasje më serioze ndaj çështjes dhe tejkalimin qëndrimeve të shumta dhe heterogjene në këtë fushë, pra është e nevojshme për të hapur një debat të gjerë teorik me qëllim të tejkalimit të problemeve të dukshme dhe të mosmarrëveshjeve në praktikën gjyqësore që për një kohë të gjatë përpiqet të gjejë një zgjidhje të vlefshme për problemet që paraqiten në këtë sferë;
- Në këtë kontekst, do të ishte e këshillueshme të marrin në konsideratë dispozitat ligjore të përfshira në tekstin e Kodit Penal të RM-së, i cili siguron mundësinë e shqiptimit të dënimeve dytësore për personat juridik (edhe për mediat) kur personi juridik ka abuzuar veprimtarinë e tij dhe kur ka rrezik në të ardhmen për të përsëritur veprën (kështu, ndalesa në pjesëmarrje në procedurat e shpalljeve publike, dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe kontratave për partneritet public dhe privat, ndalimi i krijimit të subjekteve të reja ligjore, ndalimi për të përdorur subvencione dhe kredi të tjera të favorshme, ndalimin e për alokimin e fondeve për financimin e partive politike nga buxheti i Republikës së Maqedonisë,

revokimi i lejes koncesionit, autorizimit ose ndonjë të drejte tjetër të përcaktuar me ligj të veçantë, etj).

- Në kontekstin e çështjeve të diskutuara që paraqesin pjesë integrale të kërimit tonë, besojmë se është e nevojshme për të menduar më seriozisht për marrjen e masave për të siguruar zbatimin e suksesshëm të praktikave të ndërmjetësimit kur është fjala për veprat penale shpifje dhe ofendim, e cila është në përputhje me kornizën e re legjislative, dmth me zgjidhjet e reja me Ligjin mbi procedurën penale që do të zbatohet nga janari 2012.
- Ajo do të jetë në përputhje me kuptimin modern të aspekteve të drejtësisë penale, të cilat karakterizohen me zhvillim dinamik dhe reformim në shumë drejtime në mënyrë që drejtësia penale të jetë në dispozicion për të gjithë qytetarët dhe të realizohet në kohën më të shkurtër të mundshme.
- Ne besojmë se zgjidhjet e reja që flasin në favor të aplikimit të procedurës për ndërmjetësim, mund të ketë një efekt të shumëfishët dhe në këtë kuptim të kontribuojë në lehtësimin e gjyqësorit, kur kanë të bëjnë me këto vepra penale, në të njëjtën kohë, praktika e saj mund të prodhojnë një ndikim pozitiv lidhje me palët e involvura në procedurë dhe vonesa e saj e tepruar.
- Baza e mendimeve të paraqitura qëndrojnë në idenë e vendosjes (dhe praktikimit) të procedurës për ndërmjetësim si një mjet për pajtimin midis palëve duke pasur parasysh faktin se ajo mund të jetë një zgjidhje efikase kur bëhet fjalë për vepra të cilat ndiqen me padi private, dhe në këtë kuadër përfshihen veprat e shpifjes dhe ofendimit.

LITERATURA

Alaburić, V. (1998), Sloboda izražavanja u Republici Hrvatskoj, Priručnik o slobodi javne riječi, (urednici Coliver, Sandra, Darbshire, Helen, Bošnjak, Mario), Article 19, London & Press Data, Zagreb, 1998;

Analiza e gjendjes "Liria në vend të frikës: Mbrojtja e së drejtës së tubimit paqësor dhe shprehja publike e protestës", Instituti për të Drejtat e Njeriut, FOSIM
http://ihr.org.mk/~ihrorg/images/stories/ihr_analiza_pravo_na_izrazuvanje_i_zdruzuvanje.pdf

G Buzharovska., Misoski B. (2009), Ndërmjetësimi dhe marrëveshja, MRKPK, nr. 2, 2009

Eissen, M. A. (1996, The length of civil and criminal proceedings on the case law of the European court of human rights, Council of Europe Publishing, 1996

Gordan Kallajxhiev (2010), Elementet e konceptit të gjykimit të drejtë që nuk janë përmendur shprehimisht në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Përmbledhje për nder të prof. Dr Stefan Georgievski, Fakulteti Juridik "Justiniani i parë", Shkup, 2010

Vllado Kambovski (2003), E drejta Penale – pjesa e posaçme, botimi i katërt i shtuar, Prosvetno delo, Shkup

Vllado Kambovski (2011), Komentari i Kodit Penal të RM-së, 2011;

D. Kiprijanovska , (2009) Disa aspekte të së drejtës për lirinë e shprehjes dhe mbrojtjen e saj, Përmbledhje e veprave për nder të prof. Dr Todor Xhunov, Fakulteti i Drejtësisë "Justiniani i parë", Shkup, 2009;

Shpifja dhe ofendimi në procedurat penale ndaj gazetarëve, Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë", Shkup, dhjetor 2006.;

Kodi i Gazetarëve të Maqedonisë (2008), Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

http://www.mim.org.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=88&Itemid=68&lang=mk

Lazhetiq – G. Buzhžarovska, (2004 - 2005), Vlerësimi i gjykimit brenda një kohe të arsyeshme përpara Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Vjetori i Fakultetit Juridik "Justiniani i parë", Shkup, Vol. 41, 2004/2005

Makovei, M. (2001), Udhëzues për zbatimin e nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Këshilli i Evropës, 2001.

Nikolla Matovski – Gordana Buzharovska, Gordan Kallajxhiev (2009), E drejta penale procedurale, Fakulteti Juridik "Justinian i parë", Shkup, 2009

Mill, On liberty (1859), Penguin Classics, 1985

O' Boyle, Warbick (1995), Law of the European Convention of Human Rights, Butterëords, London, Dublin, Edinburg, 1995

E drejta e lirisë së mendimit dhe të shprehjes dhe lirisë së mbledhjes dhe bashkimit paqësor, standardet ndërkombëtare dhe të brendshme dhe praktika, Instituti për të Drejtat e Njeriut, 2010.;

Radolović, A. (2008) Zaštita prava na suđenje u razumnom roku, Zbornik Pravnog fakulteta, Sveučilište u Rijeci, 2008, V. 29, Nr. 1;

Starmer V. K. (1999), European Human Rights Laë, LAG, London, 1999

N. Tupançeski, D. Kiprijanovska, F. Medarski (2009), Shpifja dhe ofendimi - Prej inkriminimit deri te dekriminalizimi, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, Shkup, 2009;

DOKUMENTE NDËRKOMBËTARE:

OKB (1948) Deklarata e përgjithshme mbi të drejtat e njeriut,
<http://www.ohchr.org/en/udhr/pages/language.aspx?langid=eng>

OKB (1966) Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike,
<http://www2.ohchr.org/english/law/ccpr.htm>

OKB (2009) Rezoluta 12/16 e Këshillit për të drejtat e njeriut pranë OKB-së,
(A/HRC/RES/12/16. Freedom of opinion and expression. Oct. 2009, para. 5 (p) 1),
<http://www.icj.org/IMG/G0916689.pdf>

OKB (2011) Komentari i përgjithshëm nr. 34 i Komitetit për të drejtat e njeriut, i miratuar në Gjenevë, 21 korrik, 2011,
<http://www2.ohchr.org/english/bodies/hrc/docs/GC34.pdf>

UE (2000) Karta e të drejtave themelore (2000/C 364/01),
http://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text_en.pdf

Këshilli i Evropës (1982), Deklarata e lirisë së shprehjes dhe informimit e Komitetit të Ministrave e miratuar me 29 prill, 1982.;

<https://wcd.coe.int/wcd/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=601273&SecMode=1&DocId=675536&Usage=2>

Këshilli i Evropës (2002) Rekomandimi nr. 2 i Komitetit të Ministrave për qasje deri tatat zyrtare e miratuar me 21 shkurt, 2002.;

<https://wcd.coe.int/wcd/VieëDoc.jsp?id=262135&Site=CM>

Rekomandimi nr. R (94) 13 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Promovimin e transparencës së medimeve, e miratuar me 22 nëntor, 1994.;

http://www.ebu.ch/CMSimages/en/leg_ref_coe_r94_13_transparency_221194_tcm6-4266.pdf

Këshilli i Evropës (2004) Deklarata për lirinë e debatit politik në medime e miratuar nga Komiteti i Ministrave me 12 shkurt, 2004,

http://www.ebu.ch/CMSimages/en/leg_ref_coe_decl_political_debate_120204_tcm6-11947.pdf

Këshilli i Evropës (2008) Konventa për qasje deri te dokumentet zyrtare e miratuar nga Komiteti i Ministrave me 27 nëntor, 2008,

<https://wcd.coe.int/wcd/VieëDoc.jsp?id=1377737&Site=CM>

Këshilli i Evropës (1950), Konventa Evropjane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, e ndryshuar dhe e shtuar me Protokolin nr 11 dhe 14,

<http://conventions.coe.int/Treaty/en/Treaties/html/005.htm>

PRAKTIKA E GJYKATËS EVROPJANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT LIDHUR ME LIRINË E MENDIMIT DHE SHPREHJES

Artico v. Italy, No. 6694/74, 13.05.1980

Bladet Tromso and Stensaas v. Norway, No. 21980/93, 20.05. 1999

Colozza v. Italy, No. 89, 12. 02. 1985, Series A

Ekbatani v. Sweden, No. 10563/83, 26.05.1988

Ensslin and Others v. FR Germany, No. 7572/76, 7586/76, 7587/76, 08.07.1978

Lingens v. Austria, No. 9815/82, 08.07.1986, Series A

Hamer v. France, No. 19953/92, 07.08.1996

Poitrimol v. France, No. 14032/88, 23.11.1993

Van Mechelen and other v. The Netherlands, No: 21363/93, 21364/93, 21427/93, 22056/93, 30.10.1997

WWW. AKADEMIKA.COM.MK (BAZA E LEGJISLACIONIT POZITIV TË RM)

Kushtetuta e RM-së, Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 52/1991

Kodi penal, Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 19/2004; 81/2005; 60/2006; 73/2006; 7/2008; 139/2008; 114/2009; 51/2011

Ligji për procedurë penale, Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 5/1997; 44/2002; 74/2004; 83/2008; 67/2009 dhe 51/2011

Ligji për Gjykatat, Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 35/08

Ligji për veprimtari radiodifuzive, Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 84/1990

Ligji organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore, Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 58/2000; 44/2002; 82/2008; 167/2010 dhe 51/2011

Ligji për punë të brendshme, Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 92/2009; 118/2009; 35/2010 dhe 36/2011

Ligji për qasje të lirë deri te informatat e karakterit publik, Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 13/2006; 86/2008 dhe 6/2010

Ligji për kundërvajtje kundër rendit dhe qetësisë publike, Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 66/2007